



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 18 tetor 2010
Ref. Nr.: RK 57/10

VENDIM PËR PALEJUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 33/09

Fillim Musa Guga

kundër

**Vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,
SCEL-08-0001 i datës 17 qershor 2008 dhe SCEL -08-0001 i datës 10 shtator 2008**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Nënkyetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe
Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi i kërkesës është Z. Fillim Musa Guga, me banim në Gjakovë.

Vendimet e sfiduara

2. Parashtruesi atakon vendimin SCEL-08-0001, i datës 17 qershor 2008, dhe vendimin SCEL-08-0001, i datës 10 shtator 2008, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtuftjeshëm "Dhoma e Posaçme").

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimet e Dhomës së Posaçme përbëjnë shkelje të Nenit 24 [Barazia para Ligjit], Nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Kushtetuta"), dhe të Nenit 1 të Protokollit 1 së Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtutjeshëm "Nenin 1 i Protokollit").

Baza juridike

4. Neni 113 (7) i Kushtetutës, Neni 22 (7) dhe (8) i Ligjit (No. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 [në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji"] dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Rregullorja e Punës").

Procedura para Gjykatës

5. Më 27 korrik 2009, Parashtruesi ka dorëzuar Kërkesën në Gjykatë dhe ka kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimeve të lartpërmendura të Dhomës së Posaçme. Më 30 janar 2010, Parashtruesi ka dorëzuar dokumente shtesë dhe ka plotësuar Kërkesën me argumente tjera.
6. Më 4 shkurt 2010, Gjykata i ka dërguar një kërkesë Dhomës së Posaçme për dorëzim në Gjykatë të atyre vendimeve të kësaj Dhome, në të cilat ishte referuar Parashtruesi në kërkesën e tij. Më 15 mars 2010, Dhome e Posaçme i dërgoi vendimet dhe dokumentet në lidhje me vendimet në fjalë.
7. Më 4 shkurt 2010, Gjykata i ka dërguar një kërkesë Parashtruesit duke kërkuar nga ai vendimet e Dhomës së Posaçme dhe dokumentet mbështetëse për deklaratat e tij të paraqitura në kërkesë. Parashtruesi i Kërkesës nuk ka kthyer përgjigje.
8. Më 24 qershor 2010, Gjykata kërkoi nga Parashtruesi të përgjigjet ndaj disa pyetjeve të veçanta, por, ai deri më tani nuk ka ofruar përgjigje në këto pyetje. Në vend të tyre, ai dorëzoi një kopje të përgjigjes të dhënë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (në tekstin e mëtutjeshëm "PSSP") për Panelin Këshilldhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut, numri i referencës 47/08, ku Parashtruesi kishte paraqitur një kërkesë të ngjashme. Paneli, megjithatë, refuzoi kërkesën e Parashtruesit për shkak se ishte e pabazë.
9. Në të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Komunale në Gjakovë dorëzimin e vendimeve të Gjykatës të cilave iu referohet Parashtruesi. Më 5 korrik 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë ia dorëzoi Gjykatës Kushtetuese kopjet e këtyre vendimeve.
10. Më 13 korrik 2010, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga Gjyqtarët Altay Surroy (kryesues), Enver Hasani dhe Ivan Čukalovič shqyrtoi Raportin e Gjyqtarës Raportuese Snezhana Botusharova dhe i dha një rekomandim Gjykatës në lidhje me papranushmërinë e Kërkesës.

Faktet

11. Nga dokumentet e parashtruara del që Parashtruesi ka punuar në Ndërmarrjen Shoqërore (NSH) KNI "Dukagjini OTHPB-BP IMN Tjegulltorja (në tekstin e mëtutjeshëm IMN) deri në vitin 1999, kur ishte i detyruar të lëshojë Kosovën dhe të shkojë në Mal të Zi për shkak të ngjarjeve që kishin ndodhur në Kosovë deri në atë kohë.

12. Marrëdhënia e Punës e Parashtruesit është ndërprerë nga Komisioni Disciplinor i IMN-së më 24 gusht 2000, me zbatim nga data 23 mars 1999 (Vendimi për ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës Nr. 185/00, 24 gusht 2000).
13. Punëtorët janë njoftuar dhe janë thirrur për një dëgjim disiplinor por vetëm disa nga ata janë përgjigjur. Parashtruesi nuk i është përgjigjur thirrjeve. IMN ka marrë parasysh situatën që kishte ekzistuar në Kosovës në atë kohë dhe për këto arsye nuk kishte ndërmarr procedurë disiplinore edhe pse kishte kaluar një vit pas këtyre ngjarjeve. Megjithatë, marrëdhënia e punës së punëtorëve që nuk janë përgjigjur dhe që kanë munguar në punë pa ndonjë arsyetim ishte ndërprerë.
14. "IMN" është privatizuar më 31 korrik 2006 dhe si pasojë, në bazë të Nenit 10 (3) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 për Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore (në tekstin e më tutjeshëm "Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13), Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e më tutjeshëm "AKM-ja") ka shpallur listën e punëtorëve që gëzonin të drejtën e fitimit të 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH. Në këtë listë duket se kanë qenë vetëm emrat e disa punëtorëve jo-shqiptarë, të cilët ishin kthyer në punë pas luftës dhe ishin përfshirë në listën e punëtorëve që gëzonin të drejtën e fitimit të 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH.
15. Siç duket, organi përfaqësues i të punësuarve në ndërmarrje në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës përcaktojnë listën e punëtorëve që gëzojnë këtë të drejtë dhe atë ia dorëzojnë AKM-së. Më pas AKM-ja shqyrton listën dhe bën ndryshimet e nevojshme për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë punëtorët që gëzojnë këtë të drejtë në fondin që do të shpërndahej. Pastaj kjo listë shpallet në gazetate kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe, së bashku me një njoftim për të drejtën e ankesës nga pala e pakënaqur.
16. Neni 10 (4) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 shprehimisht përcakton që punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Dështimi për të përmbushur një kusht të tillë nuk përjashton përfshirjen në listë të një punëtori që pohon se ai do të konsiderohej si legjitim po të mos ishte nënshtruar diskriminimit.
17. Pasi që emri i tij nuk ishte përfshirë në listën e 20 % për të ardhurat nga shitja e IMN, Parashtruesi ka parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme në bazë të Rregullores së UNMIK Nr. 2002/13 mbi Themelimin e themelimin e Dhomës së Posaçme në Gjykatën supreme të Kosovës mbi Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e më tutjeshëm: "Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13).
18. Më 17 qershor 2008, Dhoma e Posaçme konstantoi në vendimin e saj SCEL-08-0001 që Parashtruesi me të vërtetë ka punuar në NSH nga viti 1979 deri në qershor 1999. Pas muajit qershor 1999, ai ka qëndruar në Mal të Zi për një kohë të gjatë për shkak të çështjeve të sigurisë dhe pas kthimit në Kosovë ai është përpjekur të rikthehet në vendin e tij të mëhershëm të punës. Dhoma e Posaçme konstantoi që Parashtruesi kishte dështuar për të paraqitur fakte nga të cilat mund të supozohet që ai ishte diskriminuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Për më shumë, ai

kishte dështuar t'i përmbahej kushteve të Nenit 10 (6) në ndërlidhje me Nenin 10 (4) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Për këto arsye, nuk është pranuar përfshirja e tij në listën e punëtorëve legjitim.

19. Parashtruesi parashtror një ankesë kundër vendimit të Dhomës së Posaçme duke theksuar që, nëpërmjet vendimit të atakuar, atij i është mohuar e drejta e ankesës në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 (për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13).
20. Nëpërmjet Vendimit SCEL-08-0001, i datës 10 shtator 2008, Dhoma e Posaçme konstatoi që Neni 9 (7) i Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 përcakton që vendimi, i marrë lidhur me një padi, është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për palët në fjalë dhe duhet të ekzekutohet nga organet përkatëse zbatuese në pajtim me ligjin në fuqi. Sipas Dhomës së Posaçme, pretendimet e Parashtruesit nuk kanë pasur bazë ligjore në bazë të faktit që Neni 9 (5) i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, i cili mundëson apelimin e vendimeve të Dhomës së Posaçme, nuk ka qenë në zbatim dhe nuk mund të thirrej në atë. Nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 2008/29 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4, zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 është shtyrë deri më 31 tetor 2008. Prandaj kur Dhoma e Posaçme ka marrë vendim më 17 qershor 2008, Rregullorja e UNMIK-ut 2008/4 nuk ishte e zbatueshme në atë kohë.

Pretendimet e Parashtruesit

21. Parashtruesi pretendon që ai asnjëherë nuk ka pranuar vendimin e Komisionit Disiplinor dhe që ai nuk është ftuar në dëgjimin disiplinor. Për më shumë, ai pohon që asnjëherë nuk ka pranuar ndonjë përgjigje të AKM-së.
22. Parashtruesi po ashtu pretendon që, pas kthimit të tij nga Mali i Zi, ai ka tentuar të kthehet në punë por është kundërshtuar, siç pretendon, për shkak të përkatësisë Egjiptase. Ai pranon që ka ndërmarr hapa për nisjen e procedurave para gjykatave të rregullta të Kosovës për tu rikthyer në vendin e mëhershëm të punës, por kjo kërkesë e tij ishte refuzuar.
23. Parashtruesi deklaron që ai asnjëherë nuk ka dorëzuar vendimet e gjykatave të rregullta në Dhomën e Posaçme për shkak se ka besuar që objekti i padisë para Dhomës ka qenë 20 % i të ardhurave nga privatizimi. Për këtë arsye, ai ka menduar që këto nuk kanë qenë të rëndësishme.
24. Në përgjithësi, Parashtruesi ankohet që dështimi i AKM-së për të përfshirë atë, gjatë procesit të privatizimit të "IMN" dhe vendimeve pasuese të Dhomës së Posaçme, në listën e punëtorëve legjitim për 20% e të ardhurave nga privatizimi i IMN. Sipas pikëpamjes së Parashtruesit, përjashtimi nga lista është bërë në mënyrë diskriminuese për shkak të etnisë së tij Egjiptase përderisa e njëjta e drejtë nuk i është mohuar disa punëtorëve serb, që ai i përmend me emër.

Vlerësim për pranueshmërinë e Kërkesës

25. Në mënyrë që të vendosë për Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata duhet së pari të kontrollojë nëse Parashtruesi ka përmbushur kushtet e lejueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe siç janë specifikuar me Ligjin dhe Rregulloren e Punës.

26. Në lidhje me kërkesën e Parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton si vijon:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”

27. Bazuar në dokumentet e paraqitura, duket se Kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit.

28. Vendimi i formës së prerë të Dhomës së Posaçme i është marrë më 10 shtator 2008 kurse Parashtruesi ka dorëzuar Kërkesën në Sekretariatit e Gjykatës Kushtetuese më 27 korrik 2009.

29. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton që Kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme në bazë të Nenit 49 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE


Në mbështetje të Nenit 49 të Ligjit dhe të Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOS

- I. TA REFUZOJ Kërkesën si të papranueshme.
- II. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit, ky Vendim do t'i komunikohet Palëve dhe do të shpallet në Gazetën Zyrtare
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani